

VENDIM
Nr.193, datë 25.5.1990

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.111, DATË
4.4.1985 “PËR PËRQINDJEN E KONTRIBUTIT QË DERDHIN NDËRMARRJET,
INSTITUCIONET, KOOPERATIVAT BUJQËSORE DHE ORGANIZATAT SHOQËRORE
PËR SIGURIMET SHTETËRORE”.**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshillit Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.111, datë 4.4.1985, në pikën 2, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Kooperativat bujqësore të derdhen në dobi të sigurimeve shoqërore shtetërore, mbi të ardhurat e planifikuara për t’iu ndarë anëtarëve, si vijon: kooperativat bujqësore fushore 9 për qind, kooperativat bujqësore kodrinore 8 për qind, kooperativat bujqësore malore 5 për qind dhe kooperativat bujqësore të zonës verilindore e kooperativa të veçanta që janë në kushte të përafërta me këtë zonë e që përcaktohen nga Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, 3 për qind të të ardhurave”.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.1991

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI